



Planuar / Dorezuar Primijena / Prodato Received / Delivery	29.08.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSICK	5011/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.632/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.632/2022 të datës 19.07.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit komunës së Lipjanit, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datës 29.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.632/2022 e datës 19.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Komunën e Lipjanit, me datë 15.07.2022 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor për kompensimin e shpërblimit për katër (4) pagat jubilarë sipas përvojës së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 27.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit, ndërsa kjo e fundit me datë 03.08.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4530/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokolli 4194/2022 të datës 19.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për realizimin e kompensimit të shpërblimit Jubilarë me numër 01-400/01-11663 e datës 03.03.2022; Akt Emërimi i R.H. i datës 01.01.2009; ID kartela e punës e R.H.; Letërnjoftimi i R.H.; Nënshkrimi i marrësit libri intern i R.H.; Pliko me nr.R2379053 i datës 15.07.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.07.2022; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 04.08.2022; Përgjigje në ankesë e datës 03.08.2022; Vendim me nr. 01-113-18176 i datës 20.03.2019; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 09.10.2012; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 05.08.2022; Vendim me nr. 1-112/02-4/672 i datës 05.08.2022; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 23.08.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e palejuar sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se që nga data 03.03.2022 kur ka paraqitur kërkesë tek Zyra e Personelit në kuadër të Komunës së Lipjanit që t'i bëjë kompensimin e shpërblimit për pagat jubilarë sipas përvojës së punës, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *"1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj"*, ndërsa nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"*, rrjedhimisht duke marr parasysh konstatimin si më lartë se ankuesi me datë 03.03.2022 ka parashtruar kërkesë pranë organit të punësimit, ndërsa për shkak të heshtjes administrative me datë 15.07.2022 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji konstaton se ankesa është parashtruar jashtë afatit lidhur me heshtjen administrative siç parashihet me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, kështu që Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe neni 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.




Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.632/2022

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

